



Éducation Familiale Familienbegleitung

Shkollë | Shtëpi

Në shkollë, fëmija mëson të ...	Në shtëpi, ajo që mund të ndihmojë fëmijën është ...
Të punojë në kushte të mira.	<ul style="list-style-type: none">• Të bëjë një gjë në të njëjtën kohë: “Nuk luaj kur jam duke ngrënë.” “Nuk ha kur jam duke luajtur.” “Nuk luaj kur jam duke u përgatitur për të dalë”, etj.• Të ketë aktivitete të rregullta në qetësi, gjatë të cilave nuk ka ekrane.• Të shkojë në shtrat dhe të hajë pak a shumë në të njëjtën orë çdo ditë.• Të ketë rituale që strukturojnë ditën dhe japin pika referimi (p.sh. tregim para gjumit, këngë para vaktit, një kohë për lojë familjare pas punës).
T'i përmbahet një orari ose kohëzgjatjes së një aktiviteti.	<ul style="list-style-type: none">• Të luajë lojëra përqendrimi vetëm ose me persona të tjerë: puzzle, perla për t'u futur në fill, ndjekja e një tregimi, etj.
Të punojë për periudha të gjata kohore.	<ul style="list-style-type: none">• Të gatuajë me një të rritur dhe të ndjekë receta (duke peshuar ushqimet, etj.).• Të luajë në rërë, me Lego/kuba, lojëra tavoline, etj.• Të ketë kohë për të mos bërë asgjë (ai/ajo zhvillon kreativitetin e tij/saj).
Të zhvillojë strategji në lojëra matematike dhe gjëra të tjera.	<ul style="list-style-type: none">• Të jetë i/e nxitur të shkojë deri në fund të një veprimi (p.sh. të rregullojë përpara se të fillojë një aktivitet tjetër).• Të jetë i/e nxitur për të bërë përpjekje.• Të jetë përgjegjës/e për kryerjen vetëm të një detyre të vogël shtëpiake (p.sh. rregullimi/pastrimi i tavolinës).• Të luajë vetëm për pak kohë.• Të flejë vetëm në shtratin e tij/saj.
Të jetë përgjegjës/e për punën e tij/saj deri në fund të aktivitetit.	<ul style="list-style-type: none">• Të jetë i/e nxitur për të bërë gjithnjë e më shumë gjëra vetë. Të rriturit dhe fëmijët më të mëdhenjë bëjnë pak gjëra në vend të tyre.• Të ketë kohë për të provuar gjëra vetëm dhe për t'u ushtruar shpesh.
Të jetë i/e pavarur në punën e tij/saj.	<ul style="list-style-type: none">• Të jetë përgjegjës/e për rregullin dhe mirëmbajtjen e një hapësire të vogël që i përket.
Të shkojë në tualet, të shfryjë hundët, të vishet vetëm.	<ul style="list-style-type: none">• Të kujdeset për lodrat.• Të huazojë lojëra / libra dhe t'i ktheni ato në të njëjtën gjendje siç i ka marrë.• Të shohës të rriturit duke u kujdesur për gjërat.
Të ketë rregull dhe kujdes në punën e tij/saj dhe në materialin e tij/saj.	
Të respektojë materialin shkollor.	

**Të kërkojë ndihmë
kur ai/ajo nuk e ka kuptuar.**

- Të jetë i/e nxitur për të bërë pyetje.
- Të dëgjohet dhe të marrë përgjigje.
- Të dëgjojë të rriturit të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë ndihmë nga të tjerët.

**Të punojë në bashkëpunim
me nxënës të tjerë.**

- Të luajë me fëmijë të tjerë pa vështrimin e të rriturve.
- T'i kërkojë fëmijës tjetër (për të luajtur së bashku ose për të marrë një objekt)
- Të thotë "të lutem".

**Të pranojë humbjen në një lojë,
të gabojë, të mos ketë gjithmonë sukses
që me herën e parë.**

- Të jetë i/e nxitur dhe i/e përgëzuar për mësimet që ai/ajo bën, duke bërë përparime dhe duke bërë gabime (jo vetëm për rezultatin).
- Të shohë se të rriturit nuk mund të bëjnë gjithçka menjëherë.
- Të luajë lojëra ku ndonjëherë fiton dhe ndonjëherë humbet.

**Të jetë i/e durueshëm,
të mësojë të presë,
të ketë durim deri në radhën e tij/saj.**

- Të mësojë të presë, jo t'i marrë të gjitha menjëherë.
- Të përdorë një kalendar javor, me fotografi të gjërave që ai / ajo bën.
- Të luajë lojëra me radhë rolesh.

**Të respektojë të gjithë nxënësit dhe të
rriturit e tjerë
kur ata/ato flasin,
kur ata/ato e kanë gabim,
kur ata/ato janë ndryshe nga unë,
kur ata/ato kanë mendime të ndryshme
nga unë.**

- Të flasë për ditën e tij/saj dhe të dëgjojë tjetrin.
- Të dëgjojë të flitet për diversitetin dhe vlerën e secilit pjesëtar të familjes.
- Të kalojë kohë me persona në familje / vende të ndryshme.
- Të marrë pjesë në aktivitetet e lagjes apo komunës.

**Të përpiqet
edhe kur nuk ka asnjë dhuratë
si shpërblim.**

- Të kryejë një shërbim ndonjëherë pa marrë asgjë në këmbim.
- Të jetë i/e përgëzuar për arritjet e tij/saj dhe i/e falenderuar për angazhimin e tij/saj.

**Të pranojë një "jo" ose një pasojë
kur ai/ajo nuk ka ndjekur një rregull.**

- Të ketë rregulla të qarta dhe pasoja të lidhura me situatën (p.sh. rregullimi i gjërave të thyera).
- Të ushtrohet për të shprehur emocionet e veta ndërkohë që respekton njerëzit që e rrethojnë.

Të koordinojë lëvizjet e trupit të tij/saj

- Të ecë (në vend që të përdorë karrocën ose makinën), të ngjisë shkallët.
- Të kërcejë sipas ritmit të muzikës.
- Të luajë jashtë (të ngjitet, të vrapojë, të hidhet).
- Të përdorë lapsa, gërshërë, ngjites, etj.

